

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Habib Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit, I.H, të cilin e përfaqëson me autorizim av. Xh.T, kundër të paditurës Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim S.V në çështjen juridike, për pagesën e pagave jubilarë, në prezencën e të autorizuarit të paditësit, të autorizuarit të tij dhe përfaqësuesit të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur më 21 mars 2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJSËRISHT APROVOHET kërkesë padia e paditësit I.H nga fshati..., komuna e Ferizajt, si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit që në emër të 75 % të një page jubilarë t'i paguaj paditësit shumën prej 385.87 € (treqind e tetëdhjetë e shtatë euro e tetëdhjetë e shtatë cent) me kamat ligjore prej 8 % prej datës së paraqitjes së padisë 30.01.2019 deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, nën kërcënime të përmbarrimit me dhunë.

III. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë të paditësit sa i përket lartësisë 1157.63 € (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e tre cent) në emër të kompensimit të pagave jubilarë.

IV. OBLIGOHET e paditura që paditësit t'i paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 259 € (dyqind e pesëdhjetë e nëntë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, nën kërcënime të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Më datë 30.01.2019, në këtë gjykatë paditësi I.H ka ushtruar padi, me të cilën ka kërkuar që ti aprovohet kërkesë padia ndaj të paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria Komunale për Arsim, për kompensimin e tre pagave jubilarë pas pensionimit.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij në seancën kryesore ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke deklaruar se paditësit me vendim i është njohur e drejta për kompensimin e tre pagave përcjellëse, ndërsa sa i përket pagave jubilarë ka kërkuar që paditësit ti kompensohen pagat jubilarë bazuar në marrëveshjen e përgjithshme kolektive të vitit 2014.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë, për përfaqësimin në gjykatë si dhe për taksën gjyqësore.

Përfaqësuesi i të paditurës në fjalën e tij ka deklaruar se mbetet pranë përgjigjes në padi, duke deklaruar se: kompensimi i pagave jubilarë është e rregulluar me nenin 35 par.8 të kontratës kolektive e datës 18.04.2017 e nënshkruar mes SBASHK-ut dhe MASHT-it, në të cilën kontratë parashihet përfitimi sipas përvjetorit në përqindje, ashtu që për 10 vjet përvoje pune punëtori përfiton 50 % të pagës bazë, për 20 vjet përvoje pune punëtori përfiton 75 % të pagës bazë, e që bazuar në listat e pagave konstatohet se paditësi ka pasur 24 vjet përvoje pune, e që për të paditurën përvoja e punës nuk ka qenë kontestuese.

Për të vërtetuar gjendjen faktike, gjykata ka bërë ushtrimin e provave u lexua vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës pas moshës së pensionimit nr. 1168 të lëshuar nga Drejtoria për Arsim-Ferizaj të datës 17.05.2018 si dhe listat e pagave për muajt Janar dhe Shkurt të vitit 2018.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së së gjeti se kërkesë padia e paditësit është e bazuar pjesërisht.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mes palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, si dhe nuk është kontestuese përvoja e punës së paditësit 24 vjet. Për më tepër përvoja e punës vërtetohet sidomos me listat e pagave, në të cilat mes tjerash përcaktohet edhe përvoja e punës, andaj për gjykatën është i mjaftueshëm ky argument, për çka nuk është e nevojshme të vërtetohet ndonjë provë tjetër.

Me rastin përcaktimit të lartësisë të 75 % të një page jubilarë të caktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata ka marr për bazë listën e pagave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën vërtetohet se i paditësi në muajin janar 2018 ka realizuar pagë neto në lartësi prej 514.50 €.

Themelësia e kërkesëpadisë së paditësit, në aspektin ligjor buron nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë në 24 të datës 18.04.2017, e nënshkruar mes Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me anë të cilës, mes tjerash, punëdhënësi (në këtë rast Drejtoria Komunale e Arsimit-Komuna e Ferizajt) obligohet që punëmarrësi me rastin e arritjes së moshës së pensionimit t'i paguaj tre paga përcjellëse, dhe pagën jubilarë, varësisht prej përvojës së punës.

Neni 35 paragrafi 8 nënparpar.2 të Kontratës Kolektive parasheh "Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerëpër 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75 % të një page bazë". Andaj bazuar në këtë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit duke e detyruar të paditurën që paditësit në emër të 75 % të një page bazë, ta kompensoj në lartësi prej 385.87 € (treqind e tetëdhjetë e shtatë euro e tetëdhjetë e shtatë cent). Për më tepër e paditura me vendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës pas moshës së pensionimit, ja njeh të drejtën paditësit, përveç tre pagave përcjellëse dhe pagën jubilarë sipas kriterëve përkatëse.

Gjykata ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, sa i përket lartësisë së kërkuar dhe atë për 1157.63 € (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e tre cent)sepse nuk gjenë mbështetje ligjore, nga fakti se Kontrata Kolektive mes SBASHK-ut dhe MASHT-it, ka të bëjë ekskluzivisht për punëtorët e Arsimit Parauniversitar dhe Universitar si dhe për të punësuarit në Kulturë dhe kjo kontratë nuk parasheh vetëm të drejtën për paga përcjellëse apo jubilarë, por gjithashtu parasheh edhe të drejta tjera, që mund t'i gëzojnë vetëm kjo kategori, për atë arsye edhe arrihet deri te pajtueshmëria e palëve që të ketë një marrëveshje të veçantë kolektive. Në drejtim të kësaj gjykata vlerëson se, punëmarrësit nuk mund të gëzojnë të drejta parcialisht në mënyrë selektive, që do të thotë vetëm ato të drejta që konsiderojnë si të

favorshme, ndërsa të drejtat tjera eventuale të kërkohen nga akte tjera, në këtë rast nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës. Për më tepër, gjykata nuk ka gjetur ndonjë dispozitë qoftë nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, apo nga Kontrata Kolektive të datës 18.04.2017, me të cilën do të gjente mbështetje pretendimi i paditësit.

Pretendimi i të paditurës në përgjigje në padi se në rastin konkret është parashkruar kërkesa e paditësit, është e pa bazuar, për faktin se kontrata kolektive ka hyrë fuqi më 18 prill 2017, e që logjikshmërisht duket e qartë se paditësi më herët nuk ka pasur mundësi të kërkojë kompensimin e të ardhurave në emër pagave jubilarë.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të kompensimit të një page jubilarë dhe tri pagave për përcjellje në pension, paditësit i ka njohur të drejtën e kamatës nga dita e paraqitjes padisë dt.24.10.2018, deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452.1 të LPK_së, andaj obligohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 259 € dhe atë për përpilim të padisë shumë prej 104 €, për një seancë të avokatit shumë prej 135 €, si dhe për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 20 €. Edhe pse paditësi paraprakisht ka paguar taksën gjyqësore në lartësi prej 30 €, gjykata e ka aprovuar vetëm në lartësi prej 20 €, marrë parasysh se për lartësinë e kërkesëpadisë është vendosur sipas llogaritjes së Udhëzimit Administrativ nr. 01/17 Për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, i nxjerrur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr.75/19 më 21 mars 2019**

**Gjyqtari,
Habib Zeqiri**

KESHILLA JURIDIKE, kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 (shtatë) dite, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.